



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Preritur Punë/Produkt Received/Delivory	06.07.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Eedimica Org. Unit	Nr Prot In Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHOK	3961/2022		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.506/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 07.06.2022 me numër A.nr.506/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë në çështjen juridike "pezullim parandalues" kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.506/2022 e datës 07.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit të datës 03.02.2012 është i sistemuar në vendin e punës "Nëpunës për Bujqësi" në Sektorin për Bujqësi, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, ndaj të cilit me datë 03.02.2022 është paraqit kërkesa nga udhëheqësi për inicim të procedurës disiplinore. Komisioni Disiplinor i Komunës së Lipjanit me datë 08.02.2022 nxjerr vendimin me numër 1-119-6739 me të cilin vendim i shqiptohet masa disiplinore "pezullohet, nga puna zyrtari Nijazi Ibrahimimi në pozitën e punës Zyrtar për Bujqësi në Drejtorin për Bujqësi dhe Pylltari", "Pezullimi nga ushtrimi i detyrës së punës zyrtare me ndalesë 50% të pagesës deri në marrjen e Vendimit përfundimtar nga Gjykata kompetente".

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 08.02.2022 me datë 27.06.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 3310/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.06.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit. Më datë 17.06.2022 organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:* Ankesën e ankuesit të datës 07.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja e datës 02.06.2022 e Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 08.02.2022 i Komisionit Disiplinor; Njoftimi i datës 26.01.2022 nga Prokuroria Speciale/Departamenti për Korrupsion Publik dhe Krim Financiar; Akt emërimi i ankuesit; Dërgimi i lëndës i datës 03.02.2022; Kërkesa për inicim e datës 03.02.2022; Fletëkthesa mbi pranimin e vendimit të Komisionit Disiplinor; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 03.02.2022; e-mail 04.02.2022; Raporti i prezencës në punë për periudhën 01.11.2021 gjer më 16.06.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi [redacted] sipas Akt emërimit të datës 03.02.2012 është i sistemuar në vendin e punës "*Nëpunës për Bujqësi*" në Sektorin për Bujqësi, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

Ankuesi [redacted] me datë 07.06.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 3310/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor që ti aprovohet ankesa e ankuesit ndërsa vendimi i Komisionit Disiplinor të anulohet dhe ti mundësohet kthimi në vendin e tij të punës deri sa të mirët një vendim përfundimtar nga Gjykata apo Prokuroria ose lënda ti kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se: "**1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**", rrjedhimisht Kolegji në bazë të Fletëkthesës ka konstatuar se Komuna e Lipjanit e ka përcjell Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 08.02.2022 me numër 1-119-6739 në adresën e ankuesit [redacted] dhe se me datë 08.02.2022 marrësi është nënshkruar për pranimin e vendimit të lartcekur, andaj ankesa e ankuesit e datës 07.06.2022 me numër të

protokollit 3310/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankuesi ankesën kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 08.02.2022 ka pas të drejte që ta parashtoj gjegjësisht brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar edhe dispozitat ligjore të nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që ka përcaktuar se: *"Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"*, andaj Kolegji ka konstatuar se me vendimin me numër 1-119-6739 të datës 08.02.2022 të Komisionit Disiplinor është dhënë *këshilla juridike* që: *"Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil (KPM SHCK)"*, andaj vendimi i Komisionit Disiplinor nuk është lëshuar në mungesë të informacionit apo të këshillës juridike rrjedhimisht ankuesi ka pasur të drejtë të parashtojë ankesë gjegjësisht brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.506/2022**

**Valentina Kaçandolli BEKTESHI**

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

**Malsore Gashi BAJRAKTARI**



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësës së Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPM SHCK- së.

